



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovec / Municipality of Rahovec

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No (i/Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 97 Nr. i faq./Br.st/No.pg 9/13

Data/Date/Date 27.06.2023

Në mbështetje të nenit 12, pika 1 dhe pika 2, shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57, paragrafi 1, pika 1.3 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.06.2023, miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-01313-3 në Zonën Kadastrale Rahovec

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/772/23, i datës 12.6.2023 dhe merret vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510057-01313-3 në Zonën Kadastrale Rahovec, në sipërfaqe prej 446m² (katërqind e dyzet e gjashtë metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 828m² (tetëqind e njëzet e tetë metra katror) në vendin e quajtur ul.nratstva jedins., me kulturë kopsht i klsasës 2, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në bashkëposedim të Hajrullah (Bahtjar) Dula, Tasim (Bahtjar) Dula dhe Ysnije (Sefer) Dula.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës së cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë "Këmbimi i pronës private me pronën komunale".
3. Autorizohet kryetari i Komunës që, komform dispozitave ligjore në fuqi, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËSNË RAHOVEC

01Nr.97/23
Datë:27.06.2023

